



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**LISTE VERIFIKIMI PER ZBATIMIN E LIGJSHMERISE NE PROCEDURAT E
NDJEKURA NGA ZVAP, PER MASAT E MARRA PER ORGANIZIMIN E
PRAKTIKES PROFESIONALE**

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTE VERIFIKIMI PER ZBATIMIN E LIGJSHMERISE NE PROCEDURAT E NDJEKURA NGA ZVAP, PER
MASAT E MARRA PER ORGANIZIMIN E PRAKTIKES PROFESIONALE

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, e ndryshuar.
- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.
- Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, i ndryshuar me urdhër nr. 437, datë 20.7.2022, e ndryshuar.
- Shkresa e MAS me Nr. 5245 prot, datë 22.08.2023, “Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të

mësuesit për vitin mësimor 2023-2024”.

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Pika 1, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A janë bërë aplikimet për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë nëpërmjet platformës së aplikimit online?		
2	Pika 2, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka përzgjedhur kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale IAPP-në nga lista e publikuar në faqen e AKAP?		
3	Gërma a, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online shtojcën nr.5, “formulari i aplikimit”?		
4	Gërma b, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online jetëshkrimi i praktikantit?		
5	Gërma c, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online dokumentin e identitetit?		
6	Gërma ç, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online diplomat në fushën e mësuesisë ose diploma të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në R.SH” dhe listën e notave për secilën diplomë?		
7	Gërma d, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online raportin mjeko-ligjor?		
8	Gërma dh, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore?		
9	Gërma e, pika 3, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022. e ndryshuar	A ka ngarkuar kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale në platformën online vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim penal?		

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
10	Pika 4, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022 e ndryshuar	A janë dokumentet e ngarkuara në platformën online të kandidatit të interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale të skanuara nga origjinali?		
11	Pika 5, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është përjashtuar kandidati nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale nëse nuk ka ngarkuar dokumentet e detyrueshme sipas pikës 3, të nenit 14 në platformën e aplikimit online?		
12	Pika 6, Neni 14, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është përjashtuar nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale i cili ka ngarkuar në platformën e aplikimit online dokumente që dyshohet se janë të falsifikuara? A është referuar rasti në organet kompetente?		
13	Gërma a, pika 1, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022 e ndryshuar	A i është dhënë e drejta kandidatit të zhvillojë praktikën profesionale kur ka fituar diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë ose diplomë të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R. Sh.”, dhe në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në R. Sh.”, të ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar?		
14	Gërma b, pika 1, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A i është dhënë e drejta kandidatit të zhvillojë praktikën profesionale kur ka fituar diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë ose diplomë të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R. Sh.”, dhe në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në R.Sh.”, të ndryshuar, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nuk ka ushtruar profesionin e mësuesit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të kohës ?		

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
15	Gërma c, pika 1, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022 e ndryshuar	A i është dhënë e drejta kandidatit të zhvillojë praktikën profesionale kur profili ku kandidati është regjistruar për të zhvilluar praktikën profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati?		
16	Gërma a, pika 2, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është përjashtuar personi nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale nëse ka fituar diplomën e IAL-së në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, si dhe e ka ushtruar profesionin e mësuesit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të kohës, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar?		
17	Gërma b, pika 2, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022.	A është përjashtuar personi nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale nëse e ka kryer praktikën profesionale dhe ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar të mësuesit jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi?		
18	Gërma c, pika 2, neni 4, Kreu I, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është përjashtuar personi nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale nëse ka kryer të paktën një vit mësimor punë si mësues në një institucion arsimor dhe ka fituar diplomën, sipas pikës 1 të këtij neni?		
19	Gërma a, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka hartuar ZVAP listën e IAPP-ve, publike dhe/ose private, në juridiksion, në të cilat do të zhvillohet praktika profesionale dhe a e ka dërguar në DRAP, sipas modelit të shtojcës 1, “Lista e IAPP”?		
20	Gërma a, pika 2, neni 15, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka patur përparësi për t’u zgjedhur aplikuesi, për të cilin në vitin paraardhës shkollor nuk ka qenë i disponueshëm ndonjë institucion arsimor parauniversitar publik ose privat?		
21	Gërma b, pika 2, neni 15, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka patur përparësi për t’u zgjedhur aplikuesi që banon në qytetin/fshatin ku gjendet IAPP-ja, për të cilin ai ka aplikuar?		

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
22	Pika 3, neni 15, Kreu IV, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A i ka njoftuar ZVAP aplikuesit që do të zhvillojnë praktikën profesionale për IAPP-në përkatëse?		
23	Gërma b, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka hartuar ZVAP listën e praktikantëve, sipas profileve përkatëse, për çdo IAPP dhe a e ka dërguar në DRAP?		
24	Pika 4, neni 13, Kreu III, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022.	A ka dërguar drejtori i IAPP në ZVAP përkatëse listën e kandidatëve për mentorë, të shoqëruar me jetëshkrimin dhe portofolet e tyre?		
25	Pika 5, neni 13, Kreu III, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka përzgjedhur ZVAP mësuesit të cilët do të kryejnë detyrën e mentorit?		
26	Gërma c, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022.	A e ka miratuar ZVAP listën e mentorëve, mbas vlerësimit të jetëshkrimit dhe të portofoleve të tyre?		
27	Gërma ç, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka organizuar ZVAP rrjetin profesional të mentorëve për të shkëmbyer përvoja mes tyre?		
28	Gërma d, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka ndërprerë ZVAP punën e një mentori, kur ai nuk e ka kryer detyrën e tij sipas kësaj Rregulloreje, dhe a e ka zëvendësuar me një mentor tjetër si dhe ka njoftuar DRAP-in përkatës?		
29	Gërma dh, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka ndërprerë ZVAP praktikën e një praktikanti, në raste të shkeljeve, në bazë të legjislacionit në fuqi, dhe a e ka njoftuar DRAP-in përkatës?		
30	Gërma e, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka monitoruar ZVAP organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në IAPP?		
31	Gërma ë, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A i ka pajisur ZVAP praktikantët me certifikatën përkatëse për kryerjen me sukses të praktikës profesionale?		

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
32	Gërma f, pika 1, neni 7, Kreu II, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A i ka përgatitur ZVAP listën e praktikantëve që kanë fituar certifikatën, sipas IAPP-ve, dhe e dërgon në DRAP?		
33	Pika 1, neni 20, Kreu VI, (e # me Urdhër 437, 20.07.2022), e ndryshuar	A është ngritur komisioni i vlerësimit të praktikantëve me vendim të drejtuesit të ZVAP dhe a kryesohet nga përgjegjësi i sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional?		
34	Pika 1, neni 20, Kreu VI, (e # me Urdhër 437, 20.07.2022), e ndryshuar	A ka në përbërje komisioni i vlerësimit të praktikantëve: një specialist të sektorit të kurrikulës, një specialist jurist, një drejtor IAPP-je dhe një kryetar ekipi lëndor përkatës?		
35	Pika 1/1, neni 20, Kreu VI, (e # me Urdhër 437, 20.07.2022), e ndryshuar	A ka organizuar, realizuar dhe përfunduar procedurat për vlerësimin e praktikantëve, drejtoria e institucionit arsimor dhe ZVAP brenda një afati 30-ditor nga data e përfundimit të praktikës profesionale nga praktikantët?		
36	Gërma a, pika 2, neni 20, Kreu VI, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022., e ndryshuar	A ka shqyrtuar komisioni dosjen e praktikantit që përmban dokumentin “Vlerësimi i praktikantit” nga mentori dhe portofolin e praktikantit?		
37	Gërma b, pika 2, neni 20, Kreu VI, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A e ka intervistuar komisioni praktikantin?		
38	Pika 3, neni 20, Kreu VI, (e # me Urdhër 437, 20.07.2022), e ndryshuar	A e ka vlerësuar komisioni “Dobët” praktikantin, kur në të paktën një kompetencë ka vlerësimin “Dobët”? A e ka shtyrë komisioni në këtë rast afatin e zhvillimit të praktikës profesionale në një muaj? A i është dhënë mundësia praktikantit të shtyjë afatin deri në tri herë? A i është dhënë mundësia praktikantit ta zhvillojë praktikën profesionale në të njëjtin institucion arsimor?		
39	Pika 4, neni 20, Kreu VI, (e # me Urdhër 437, 20.07.2022), e ndryshuar	A e ka vlerësuar komisioni “Dobët” praktikantin, kur në vlerësimin tërësor ka vlerësimin “Dobët”. Në këtë rast, komisioni a e ka shtyrë afatin e zhvillimit të praktikës profesionale në një periudhë mësimore?		

Nr .	Baza ligjore	Pyetje	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
40	Pika 5, neni 20, Kreu VI, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka vendosur komisioni për certifikimin e praktikantit në bazë të shqyrtimit të dosjes dhe intervistës së tij? A i ka marrë Komisioni vendimet me shumicën e votave?		
41	Pika 6, neni 20, Kreu VI, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është përgatitur certifikata e praktikës profesionale nga ZVAP, nënshkruar dhe vulosur nga drejtuesi i ZVAP përkatëse dhe a i është dorëzuar praktikantit?		
42	Pika 6, neni 20, Kreu VI, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022.	A është ruajtur një fotokopje e certifikatës në arkivin e ZVAP?		
43	Pika 2, neni 21, Kreu VII, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A i është dhëna e drejta praktikantit të ankohet te drejtori i ZVAP-së përkatëse për vlerësimin përfundimtar të bërë nga IAPP-ja?		
44	Pika 3, neni 21, Kreu VII, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A është paraqitur ankimi me shkrim i praktikantit për vlerësimin e mentorit, brenda tri ditëve pune nga marrja e vlerësimit?		
45	Pika 4, neni 21, Kreu VII, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022. e ndryshuar	A i është nisur përgjigja me shkrim praktikantit brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së ankimit?		
46	Pika 5, neni 21, Kreu VII, Urdhër Nr. 100, datë 25.2.2022, e ndryshuar	A ka dhënë komisioni i vlerësimit të praktikantëve në ZVAP përgjigjen përfundimtare për praktikantin?		
47	Gërma b, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.	A jep grupi i inspektimit rekomandimet përkatëse për shkeljet e konstatuara?		

INSPEKTORËT